

- I. LISTA ME PËRMBAJTJEN E RAPORTIT TË MONITORIMIT**
- II.** Hytje
- III.** Informacion buxhetor i agreguar për buxhetin e AIDSSH-së Janar – Dhjetor 2025
- IV.** Performanca e treguesve kyç të performancës me bazë gjinore në nivel produkti
- V.** Performanca e buxhetit në nivel programi
- a. V.1 Performanca financiare e programit buxhetor*
- b. V.2 Performanca jo - financiare e programit buxhetor*
- c. V.3 Veprimet vijuese në nivelin e programit buxhetor*
- VI.** Projektet kapitale
- VII.** Nryshimet në buxhet
- VIII.** Përfundime

Anekset bashkëlidhur:

- Aneksi nr. 1 Raporti përmbledhës i shpenzimeve të institucionit buxhetor
- Aneksi nr. 1.1 Raporti i shpenzimeve të institucionit buxhetor sipas kapitujve
- Aneksi nr.1.2 Shpenzimet buxhetore në total programi dhe institucioni buxhetor
- Aneksi nr. 2 Raporti mbi Ekzekutimin e Buxhetit në nivelin e Programit të Buxhetit"
- Aneksi nr.2.1 Shpenzimet e programit sipas kapitujve
- Aneksi nr. 3 Raporti i performancës së produkteve të programit
- Aneksi nr. 3.1 Raporti i performancës së produkteve të programit sipas artikujve
- Aneksi nr. 3.2 Deviacioni koston për njësi në vite
- Aneksi nr. 4. Raporti i realizimit të treguesve të performancës së programit

II. HYRJE

Autoriteti për Informimin mbi dokumentet e Ish Sigurimit të Shtetit është inatitucion i pavarur që ushtron veprimtarinë e tij në zbatim të Ligjit nr. ligjit 45/2015 “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore” i ndryshuar dhe konsiston në këto drejtime:

- Përpunimi i kërkesave për informim nga Institucionet dhe individët dhe sigurimi i aksesit të qytetarëve në të dhëna nëpërmjet procedurave të qarta dhe transparente, me afate për periudhën 29 nëntor 1944 – 2 korrik, 1991.
- Rritja e cilësisë së funksionimit të Autoritetit nëpërmjet procedurës së përpunimit të kërkesave për informim të individëve të prekur dhe autoriteteve kushtetuese dhe institucioneve publike.
- Sigurimi i aksesit në të dhëna për kërkuesit historianë dhe median si subjekte të parashikuara nga ligji 45/2015, nëpërmjet procedurave të qarta dhe transparente, me afate për periudhën 29 nëntor 1944 – 2 korrik 1991.
- Mbrojtja e të dhënave e në mënyrë të veçantë e atyre të dhënave që përbëjnë informacion të klasifikuar dhe e të dhënave personale
- Ndjekja e zbatimit të strategjive ndërsektoriale në kuadër të të drejtës për informim, lidhur me indikatorët e matshëm.
- Identifikimi dhe Rikuperimi i personave të Zhdukur.

Qëllimi i Autoritetit është (i)të identifikojë, mbledhë dhe krijojë një arkiv të integruar të të gjitha dokumenteve të njohura të prodhuara nga/ose të lidhura me veprimtarinë e ish-Sigurimit, (ii) të bëjë regjistrimet në dispozicion të publikut sipas dispozitave të parashikuara në ligj, duke përfshirë sigurimin e qasjes në informata në formë dixhitale;(iii) krijimi i Autoritetit si një burim arkivor qendror, për hulumtimin e aktiviteteve të ish-Sigurimit, (iv) të drejtojë informimin publik për të krijuar Autoritetin si një platformë, për angazhimin dhe kuptimin e së kaluarës komuniste në Shqipëri, (v) mbështesë punën e dokumentimit të krimeve të komunizmit, duke përfshirë kontributin në bërjen e drejtësisë, (vi) mbështesë procesin e kërkimit, gjetjes, identifikimit dhe rimëkëmbjes së mbetjeve të atyre që u zhdukën ose u ekzekutuan gjatë komunizmit, (vii) mbështesë verifikimin e zyrtarëve që konkurrojnë për tu zgjedhur ose emëruar në administratën publike/shtetërore.

III. INFORMACION BUXHETOR I AGREGUAR PËR BUXHETIN E AIDSSH JANAR – DHJETOR 2025

Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit për vitin 2025 administron dhe menaxhon fondet buxhetore për programin:

➤ **Planifikim, Menaxhim dhe Administrim (01110)**

Në ligjin nr.115/2024, “Për buxhetin e vitit 2025 ”, numri i përgjithshëm i punonjësve mbështetur në Vendimin e Kuvendit nr. 113/2023 “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 95/2016 për miratimin e strukturës, organikës dhe klasifikimin e pagave të Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit”, të ndryshuar, është **73**.

Për vitin 2025, mbështetur në ligjin e buxhetit, 115/2024 “Për buxhetin e vitit 2025” fondet e akorduara për Autoritetin në fillim të vitit janë në total **168,200,000 lekë**.

Me shkrësën Ministrisë së Financave nr.203, datë 07.02.2025, “Mbi miratimin e detajimit të planit për fondin e vecantë për vitin 2025”, u miratua vlera prej 100.000 lekë në llogarinë 606

(transfera tek individet). Me shkrësën Ministrisë së Financave nr.12407/1, datë 01.09.2025, “Mbi miratimin e akordimit të fondit të vecantë për vitin 2025”u shtua fondi prej 60,000 lekë në llogarinë 606 (transfera tek individet) .

Me shkrësën Ministrisë së Financave nr.2571/1, datë 12.02.2025, “Mbi miratimin e rialokimit të buxhetit për vitin 2025”, Autoritetit ju alokua vlera prej 400.000 lekë në llogarinë 606 (transfera tek individet) duke pakësuar llogarinë 602(mallra dhe shërbime).

Në total llogaria 606 është 560,000 lekë.

Me shkrësën e Ministrisë së Financave nr.14505/21, datë 24.10.25, “Dergohet miratimi i ndryshimit të buxhetit për vitin 2025”, planit të buxheti të Autoritetit ju shtua vlera 3.000.000 lekë në llog 600 (paga).

Mbështetur në aktin normativ nr. 11, datë 19.12.2025” Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin 115/2024 , “ Për buxhetin e vitit 2025” u pakësua llogaria 602(mallra dhe shërbime) në vlerën 3,000,000 lekë dhe llogaria 231 (shpenzime kapitale) në vlerën 1,800,000 lekë.

Në total plani i buxhetit me ndryshime për vitin 2025 është **166,560,000 lekë**.

Nga fondi i përgjithshëm buxhetor i planit të buxhetit të rishikuar për vitin 2025, janë shpenzuar në total **159,480,173 lekë**. Buxheti në total për periudhën 12-mujore është realizuar në masën **96%**.

Fondi i pagave me plan buxheti fillestar 132,100 mijë lekë i ndarë respektivisht 112,900 mijë lekë (artikulli 600) për paga dhe 19,200 mijë lekë (artikulli 601) për sigurime, pas shtesës prej 3,000 mijë lekë në fondin e pagave (artikulli 600) në total 135,100 mijë lekë është realizuar për numrin faktik të punonjësve respektivisht në vlerën 115,274 mijë lekë për paga si dhe 18,809 mijë lekë për kontribute në sigurimet shoqërore e shëndetësore. E shprehur në përqindje realizimi i fondit të pagave për 12 mujorin është 99 % e fondit të planifikuar vjetor.

Në fund të 12-mujorit 2025 numri i punonjësve në organikë të cilët rezultojnë në listen e pagave është 69 punonjës nga të cilët rezultojnë në fondin e pagave 68 punonjës (1 punonjes trajtohet nga fondi i sigurimeve shoqerore per leje lindje, 1 punonjes paguhet si invalid i pjesshëm me 6 orë pune dhe deri në fund të dymbëdhjete mujorit ka pasur tre punonjës të trajtuar nga Sigurimet Shoqërore të cilët kanë patur mbi 14 dite raport mjekësor).

Për periudhen janar-dhjetor 2025 janë përfshirë në fondin e pagave 7 punonjës të rinj dhe tre punonjës janë larguar. Numri total i punonjësve të shtuar në fondin e pagave është katër punonjës.

Në vendimin 19 datë 09.01.2025 numri i punonjësve me kontratë të përkohshme të miratuar për Autoritetin është 14 punonjës dhe numri faktik i punonjësve gjatë 12-mujorit 2025 është 10 punonjës.

Zëri mallra dhe shërbime me plan vjetor buxheti te rishikuar 23,260 mijë lekë për periudhën Janar-Dhjetor 2025 është realizuar në vlerën 17,855 mijë lekë. Në këtë zë përfshihen fondi për shpenzime operative (artikulli 602) në vlerën 22,700 mijë lekë dhe 560 mijë lekë (artikulli 606) janë transfera te individët (400 mijë lekë per rimbursimin e telefonisë celulare dhe 160 mijë lekë pagesa nga fondi i veçantë).

Shpenzimet operative për periudhën Janar-Dhjetor 2025 janë realizuar në vlerën 77 % e planit total vjetor të rishikuar.

Vlera e pa shpenzuar në zerin 602 mallra dhe shërbime është 5,301 mijë lekë.

Nga ky fond vlera 2,500 mijë lekë e parashikuar për procedurën e skanimit të dokumenteve arkivore nuk është shpenzuar. Kjo procedurë ishte parashikuar të realizohej nëpërmjet marrëveshjes kuadër. Procedura e prokurimit përfundoi në muajin nëntor por u ankimua në APP nga një operator ekonomik. Nisur nga ky fakt marrëveshja dhe kontrata e sapo lidhur u

pezullua. Në këtë kuadër mbetën fonde të pashpenzuara. KPP u shpreh me vendim në Janar 2026 duke refuzuar kërkesën e operatorit ekonomik dhe lënë në fuqi vendimin e Autoritetit Kontraktor. Aktualisht është hequr pezullimi i marreveshjes dhe po vijohet me skanimin e dokumentave arkivore.

Zëri “Sherbim, zhvillim konceptim artistik te materialeve audiovizuale” në vlerën 1,200 mijë lekë nuk është realizuar për shkak të dështimit të sistemit të tregut. Nuk u paraqitën oferta nga operatorët ekonomikë në të tre rastet e kërkuara.

Zëri “Shpenzime për mirëmbajtjen e softwerit të arkivës digjitale” me vlerë 361 mijë lekë nuk u realizua si rezultat i moslikuidimit të dy faturave të lëshuara nga operatori ekonomik për te cilat grupi i marrjes në dorëzim nuk shprehu dakortësi për cilësinë dhe kryerjen e standarteve të shërbimit.

Diferenca prej 1,240 lekë është vlerë e pashpenzuar nga kursimet.

Fondi për shpenzime kapitale të trupëzuara (zëri 231). Për vitin 2025 fondi fillestar i akorduar për shpenzime kapitale për Autoritetin është në vlerën 10,000 mijë lekë. Me aktin normativ nr. 11, datë 19.12.2025” Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin 115/2024 , “ Për buxhetin e vitit 2025” u pakësua llogaria 231 (shpenzime kapitale) në vlerën 1,800,000 lekë. Plani i rishikuar i buxhetit në zërin “Investime “ (artikulli 231) për vitn 2025 është 8.200 mijë lekë.

Realizimi i planit të investimeve është 7,542 mijë lekë ose 92% e planit total për investime.

Realizimi faktik për secilin nga projektet është si më poshtë:

1- **Projekti me kod 18BV408** / emërtim “Blerje orendi, mobilje zyre”, me plan 1,000,000 lekë : është realizuar në vlerën 952,188 lekë e shprehur në përqindje 95% e planit. Realizimi faktik është 100%. Diferenca është fond i ngelur nga kursimet.

2- **Projekti me kod 18BV402/** emërtim “Blerje paisje informatike”, në vlerën 1,000,000 lekë pas rialokimit të fondit me shkresën nr. 10664/1, date 17.07.2025 “Transferim fondi për shpenzime kapitale” të Ministrisë së Financave, është shtuar me 200,000 lekë. Vlera pas rialokimit është 1,200,000 lekë. Projekti është realizuar në vlerën 626,400 lekë ose 52% e planit. Diferenca e mbetur është rezultat i dështimit të procedurës të prokurimit.

Në procedurën me numër reference : REF-71695-12-10-2025 arsyeja e anulimit është tërheqja e operatori ekonomik fitues para fzés së nënshkrimit të kontratës pasi kanë konstatuar rritje të cmimit të një produkti. Si rrjedhojë duke qene operatori ekonomik i vetëm kjo procedure anulohet.

E njëjta procedure me të njëjtin objekt prokurimi është rihedhur përsëri me numër reference : REF-73076-12-22-2025 dhe arsyeja e anulimit është tërheqja e operatori ekonomik fitues i renditur i treti për arsye të mosllogaritjes së saktë të ofertës.

3- **Projekti me kod 18BV409** / emërtim “Zhvillim dhe plotësim i mediatekës” me vlerë fillestare 3,000 mijë lekë pas pakësimit me Aktin Normativ nr.11, datë 19.12.2025 ka vlerën 2,410 mijë lekë. Realizimi faktik i këtij projekti është 2,394 mijë lekë ose 99% e planit të buxhetit.

4- **Projekti me kod 18BV410** / emërtim “ Blerje dhe instalim të paisjeve të rrjetit, serverave, licenca për backup dhe sigurinë kibernetike” me vlerë fillestare 4.000 mijë lekë, pas pakësimit me Aktin Normativ nr.11, datë 19.12.2025 ka vlerën 3,370 mijë lekë. Realizimi faktik i këtij projekti është 3,358 mijë lekë ose 100% e planit të buxhetit.

5- **Projekti me kod 18BV411** / emërtim “ Rinovim dhe mirëmbajtje e faqes Web” me plan fillestar në vlerën 1,000 lekë pas rialokimit të fondit me shkresën nr. 10664/1, datë 17.07.2025 “Transferim fondi për shpenzime kapitale” të Ministrisë së Financave, është pakësuar me

200,000 lekë. Me Aktin Normativ nr.11, datë 19.12.2025 ky project ka vlerën 220 mijë lekë. Realizimi faktik i këtij projekti është 212 mijë lekë ose 96% e planit të buxhetit. Vlera e kontratës të prokuruar është 500,000 lekë. Diferenca prej 288,000 lekë i përket shpenzimeve për mirmbajtjen e faqes web me afat kohor 24 muaj dhe vlere mujore 12,000 lekë të cilat do të likujdohen nga fondi shpenzimeve korrente llogaria 602.

Grandi i financiar nga Komisioni Ndërkombëtar për Personat e Zhdukur

Nga grandi i financiar nga Komisioni Ndërkombëtar për Personat e Zhdukur (ICMP) për projektin "Mbështëjtja e drejtësisë tranzitore dhe trajtimi i të shkuarës në Shqipëri" është arkëtuar vlera **2,070,579** lekë.

Kjo vlerë mbulon shpenzimet për pagesën e pagës dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të koordinatorit të projektit.

Për periudhën 12- mujore janë shpenzuar në total **1,788,000** lekë, në zërin shpenzime për paga kapitulli 06 nga të ardhurat jashtë limitit.

IV. PERFORMANCA E TREGUESVE KYÇ TË PERFORMANCËS ME BAZË GJINORE NË NIVEL PRODUKTI

Në programin buxhetor 01110 "Planifikim, Menaxhim dhe Administrim", produkti 99501AA (Kërkesa të Trajtuara) adresohen çështjet e barazisë gjinore si:

- Numri i punonjësve gra në fund te 12- mujorit ndaj numrit të përgjithshëm të punonjësve gjithsej në institucion është 46 ose 65% ndaj totalit të numrit të përgjithshëm të punonjësve.
- Numri i punonjësve gra në poste drejtuese është 19 ndaj numrit total të drejtuesve që është 26. E shprehur në % është afërsisht 73% e totalit.
- Në total në Autoritet janë 5 punonjës me tituj shkencorë, 4 nga të cilat janë punonjës gra.
- Janë kryer 23 aktivitete ku përfshihen simpoziume, konferenca, përkujtimore, klubi i librit të cilat janë organizuar nga drejtuese gra.

Puna, organizimi dhe pjesëmarrja në aktivitete e drejtuesve gra në Autoritet është bashkëpunuese dhe ndikon drejtpërdrejt në performancën e institucionit. Gratë janë tregues kyç i rëndësishëm nëpërmjet të cilit hartohen politikat e institucionit, shprehet realizimi financiar dhe performanca e tij, dhe rrjedhimisht edhe realizimi i produkteve/objektivave të cilit i jepet përparësi.

V. PERFORMANCA E BUXHETIT NË NIVEL PROGRAMI

V.1 Performanca financiare e programit buxhetor

Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish Sigurimit të Shtetit buxhetohet vetëm nëpërmjet 1 (një) programi buxhetor "Planifikim, Menaxhim dhe Administrim" me kod 01110 i cili ka në strukturë 1 (një) produkt buxhetor "Kërkesa të trajtuara" me kod 99501AA

Ecuria e shpenzimeve sipas klasifikimit ekonomik, paraqitet si më poshtë:

- I. **Shpenzimet Korrente janë realizuar në masën 96% e planit të shpenzimeve korrente:**
- a) Shpenzime për paga artikulli 600 në masën 99%
 - b) Shpenzimet për sigurimet shoqerore dhe shëndetësore artikulli 601 në masën 98%
 - c) Shpenzimet operative, artikulli 602, në masën 77% .
transfertat nga buxheti, artikulli 606, në masën 81 %
- II. **Shpenzimet kapitale në planin financiar janë realizuar në masën 95% e planit të investimeve si me poshtë:**
- a) **Projekti me kod 18BV408** / emërtim “Blerje orendi, mobilje zyre”, 95% e planit.
 - b) **Projekti me kod 18BV402** / emërtim “Blerje paisje informatike”, 52% e planit
 - c) **Projekti me kod 18BV409** / emërtim “Zhvillim dhe plotësim i mediatekës” 99% e planit
 - d) **Projekti me kod 18BV410** / emërtim “ Blerje dhe instalim të paisjeve të rrjetit, serverave, licenca për backup dhe sigurinë kibernetike” 100% e planit.
 - e) **Projekti me kod 18BV411** / emërtim “ Rinovim dhe mirëmbajtje e faqes Web” 96% e planit.

V.2 Performanca jo - financiare e programit buxhetor

Autoritet ka parashikuar në programin e tij buxhetor të vitit 2025 realizimin e treguesve të performancës në nivel qëllimi si dhe objektivat e politikës së programit.

Misioni, qëllimi dhe objektivat e Autoritetit identifikohen me një sërë treguesish, objektivash dhe produktesh të cilat paraqesin në shifra misionin dhe synimin e Autoritetit për të ardhmen. Më poshtë gjeni realizimin e treguesve të performancës , objektivat e politikës së programit dhe produkteve të programit.

Treguesi i performancës në nivel qëllimi për 12- mujorin paraqitet me

- Numrin e aktiviteteve dhe botimeve 90 ose 95% e planit
- Numrin e kërkesave 902 ose 95% e planit

Objektivat e politikës së programit për 12-mujorin shprehen nëpërmjet

- Numrit të faqeve të vëna në dispozicion 135024 ose 180% e planit
- Numri i ankesave është zero ose 100%
- Përqindjen e grave në poste drejtuese të institucionit ndaj totalit të posteve drejtuese 73% ose 108% e planit
- Numri i rasteve të diskriminimit me bazë gjinore të trajtuara është zero ose 100% e planit

Produkti “ Kërkesa të trajtuara “ me kod 99501AA ka të bëjë me trajtimin e të gjitha kërkesave të paraqitura në Autoritet si dhe aktiviteteve të ndryshme të realizuara në kuadër të ndërgjegjësimit të individit dhe insitucineve për të drejtën e tyre/aksesin në informacionin/ dokumentacionin arkivor të Autoritetit. Ky produkt është realizuar në masën 95 % .

Produktit “Kërkesa të trajtuara” për 12-mujorin është 1701. Këtu përfshihen

- Numri i kërkesave sipas objektit të tyre
 1. Kërkesa Individuale 986
 2. Kërkesa Studimore 630
 3. Kërkesa Institucionale 85
- Aktivitetet në kuadër të ndërgjegjësimit të individit (simpoziume, konferenca, përkujtime), leksione të hapura, klube libri në total është 31.
- Numri i faqeve të vëna në dispozicion është 135,024 .

- Eshtë bërë përpunimi i 110.000 faqeve nga të cilat 36.578 faqe janë të anonimizuara

V.3 Veprimet vijuese në nivelin e programit buxhetor

Në nivelin e **programit buxhetor**, për të mundësuar realizimin me sukses të objektivave puna do të përqëndrohet kryesisht në veprimet/aktivitetet e organizuara sipas qëllimeve dhe objektivave të programit ku përfshihen kryesisht:

- Përcaktimi i objektivave dhe rezultateve të pritshme
- Hartimi i aktiviteteve dhe parashikimi i kostove që do të realizohen
- Parashikimi i kostove dhe burimeve financiare dhe shpërndarja sipas zërave ekonomikë
- Menaxhimi i burimeve njerëzore dhe materiale.

Veprimet vijuese do të lidhen me ndjekjen e realizimit të shpenzimeve dhe krahasimin e rezultateve me objektivat e Autoritetit.

Referuar realizimit të shpenzimeve për periudhën Janar-Dhjetor 2025, për të mundësuar realizimin me sukses të objektivave për vitin 2026 puna do të përqëndrohet kryesisht në obligimin e burimeve njerëzore në ato procese që deri tani nuk paraqiten të realizuara plotësisht.

Vëmëndje do të kushtohet rritjes së cilësisë së dokumentave/proceseve të punës që është thelbësore për përmirësimin e rezultateve dhe realizimin e planit që lidhet me prokurimin e fondeve buxhetore, për të reduktuar në maksimum riskun e mosrealizimit të procedurave. Gjithashtu vëmëndje do të kushtohet përmirësimit të efikasitetit për kryerjen sa më mirë të punës, sa më shpejt dhe me sa më pak shpenzime lidhur me aktivitetet e përcaktuara në kuadër të realizimit të objektivave.

VI. PROJEKTET KAPITALE

Nuk kemi projekte të mëdha kapitale në implementim.

VII. NRYSHIMET NË BUXHET

Buxheti i planifikuar në fillim të vitit në total ishte **168,200,000 lekë**. Gjatë vitit kemi ndryshime në buxhet dhe rialokim fondi si më poshtë:

-Alokim fondi i veçantë me shkrësën e Ministrisë së Financave nr.203, datë 07.02.2025, “Mbi miratimin e detajimit të planit për fondin e vecantë për vitin 2025” në vlerën 100.000 lekë në llogarinë 606 (transfera tek individet).

-Akordim fond i veçantë me shkrësën Ministrisë së Financave nr.12407/1, datë 01.09.2025, “Mbi miratimin e akordimit të fondit të vecantë për vitin 2025” në vlerën 60,000 lekë në llogarinë 606 (transfera tek individet).

-Rialokim fondi me shkrësën Ministrisë së Financave nr.2571/1, datë 12.02.2025, “Mbi miratimin e rialokimit të buxhetit për vitin 2025” në vlerën 400.000 lekë në llogarinë 606 (transfera tek individet) duke pakësuar llogarinë 602(mallra dhe shërbime).

-Rialokim fondi me shkrësën nr. 10664/1, date 17.07.2025 “Transferim fondi për shpenzime kapitale” të Ministrisë së Financave, duke pakësuar 200 mijë lekë **Projekti me kod 18BV409/**

emërtim “Zhvillim dhe plotësim i mediatekës” dhe shtuar me 200 mijë lekë **Projekti me kod 18BV402/** emërtim “Blerje pajisje informatike”

-Shtesë fondi me shkrësën e Ministrisë së Financave nr.14505/21, datë 24.10.25, “Dërgohet miratimi i ndryshimit të buxhetit për vitin 2025” në vlerën 3.000.000 lekë në llog 600 (paga).

- Pakësim fondi mbështetur në aktin normativ nr. 11, datë 19.12.2025” Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin 115/2024 , “ Për buxhetin e vitit 2025” në llogarinë 602(mallra dhe shërbime) në vlerën 3,000,000 lekë dhe llogaria 231 (shpenzime kapitale) në vlerën 1,800,000 lekë.

Buxheti me ndryshime në total për vitin 2025 është **166,560,000 lekë**.

Aktualisht fondet janë të alokuar tek një program buxhetor dhe nuk kemi kalime ndërmjet programesh por kemi ndryshim ndërmjet produkteve, zërave dhe artikujve artikujve.

VIII. PËRFUNDIME

Në mbështetje të ligjit nr. 45/2015 “Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të RPSSH” i ndryshuar, qëllimi përcaktues dhe detyra prioritare e Autoritetit për Informim mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë është marrja në shqyrtim e kërkesave të paraqitura nga individët.

Për realizmin e Buxhetit të 12-mujorit të vitit 2025 është punuar dhe janë angazhuar të gjitha strukturat e Autoritetit me qëllim përdorimin me efikasitet dhe efektivitet të fondeve të planifikuara. Realizimi i buxhetit për këtë periudhë është monitoruar me përgjegjësi nga Grupi i Menaxhimit Strategjik.

Produktet e realizuar për vitin 2025 janë :

Kërkesa individuale

Kërkesa institucionale

Kërkesa studimore

Klubi i librit

Aktivitete ndërgjegjësuëse (simpoziume,konferenca,përkujtimore)


Në ushtrim të detyrës është punuar me prioritet në kuadër të procesit të mbrojtjes të të dhënave gjatë përpunimit dhe dhënies së informacionit, në mënyrë të veçantë e atyre të dhënave që përbëjnë informacion të klasifikuar si dhe zbatimi i përpiktë i ligjit nr. 9887/2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” (i ndryshuar), si dhe ligjit nr.119/2014 “Për të Drejta për Informim”. Krahas garantimit të integritetit të procesit në përgjithësi në dhënien e informacionit, duke e bërë këtë të fundit, lehtësisht të aksesueshëm, të saktë dhe të plotë, për aq sa e lejon ligji, në funksion të mbrojtjes së të dhënave personale, interesit publik dhe sigurisë kombëtare.

ANEKSI nr.1 Raporti Përmbledhës i Shpenzimeve të Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish Sigurimit të Shtetit

Periudha e Raportimit 12-2025

në/lekë

Emri i Grup Autoriteti për te Drejten e Informimit		Kodi i grupit										
		Shpenzimet e Ministrisë/Institucionit										
Viti paraardhës 2024	Struktura e shpenzimeve në %	Periudha raportuese		Periudha raportuese		Periudha raportuese		Periudha raportuese		Struktura e shpenzimeve në %	% e realizimit	
		Shpenzime Faktike	Plani i vjetër i Rishikuar Viti 2025	Plani i vjetër i Rishikuar Viti 2025	Ndryshimi i planit vjetor	Shpenzime Faktike të Periudhës/Progresit e	Ndryshimi i planit vjetor	Ndryshimi i planit vjetor	Ndryshimi i planit vjetor			
(1)	(2)	(3)	(4)	(5)	(6)	(7 (5-3))	(8)	(9)	(10 (6-6))	(11 (8/6))		
Shpenzimet sipas programeve buxhetore												
Emërtimi												
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	160,003,289.52	100	168,200,000.00	100	166,560,000.00	100	1,640,000.00	159,480,173.00	100	7,079,827.00	96
Totali i Shpenzimeve buxhetore të Ministrisë (Kap 01,02,03,04,05,06,22)		160,003,289.52	100	168,200,000.00	100	166,560,000.00	100	1,640,000.00	159,480,173.00	100	7,079,827.00	96
Shpenzime nga te Ardhurat jashte limitit (Kap 06)		298,000.00		2,070,575.00		2,070,575.00			1,788,000.00		282,575.00	86
Totali Shpenzimeve të Ministrisë		160,301,289.52							161,268,173.00		7,362,406.00	
Shpenzimet sipas klasifikimit ekonomik												
Emërtimi												
600	Paga	105,819,795.00	66	112,900,000.00	67	115,900,000.00	69	0.00	115,274,387.00	72	625,613.00	99
601	Sigurime Shoqërore	17,119,696.00	11	19,200,000.00	11	19,200,000.00	12	0.00	18,808,948.00	12	391,052.00	98
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	23,010,750.52	14	26,100,000.00	16	22,700,000.00	14	-400,000.00	17,398,669.00	11	5,301,311.00	77
603	Subvencione	0.00	0	0.00	0	0.00	0	0.00	0.00	0	0.00	0
604	Transferenca Korante të Brendshme	0.00	0	0.00	0	0.00	0	0.00	0.00	0	0.00	0
605	Transferenca Korante të Huaja	0.00	0	0.00	0	0.00	0	0.00	0.00	0	0.00	0
606	Trans per Buxh. Fam. & Individ	643,940.00	0	0.00	0	560,000.00	0	560,000.00	455,961.00	0	104,039.00	81
Non-Totali Shpenzime Korrente		146,594,181.52	92	158,200,000.00	94	158,360,000.00	95	160,000.00	151,937,885.00	95	6,422,015.00	96
230	Kapitale të Patrupezuara	0.00	0	0.00	0	0.00	0	0.00	0.00	0	0.00	0
231	Kapitale të Trupëzuara	13,409,108.00	8	10,000,000.00	6	8,200,000.00	5	0.00	7,542,188.00	5	657,812.00	92
Non-Totali Shpenzime Kapitale me financim të brendshëm		13,409,108.00	8	10,000,000.00	6	8,200,000.00	5	0.00	7,542,188.00	5	657,812.00	92
230	Kapitale të Patrupezuara	0.00	0	0.00	0	0.00	0	0.00	0.00	0	0.00	0
231	Kapitale të Trupëzuara	0.00	0	10,000,000.00	0	8,200,000.00	0	0.00	7,542,188.00	92	657,812.00	0
Non-Totali Shpenzime Kapitale me financim të huaj		0.00	0	10,000,000.00	0	8,200,000.00	0	0.00	7,542,188.00	92	657,812.00	0
Totali Shpenzime Kapitale		13,409,108.00	8	10,000,000.00	6	8,200,000.00	5	0.00	7,542,188.00	5	657,812.00	92
Totali i Shpenz. Buxhetore të Ministrisë/Institucionit Buxhetor		160,003,289.52	100	168,200,000.00	100	166,560,000.00	100	160,000.00	159,480,173.00	100	7,079,827.00	96
Shpenzime nga te Ardhurat Jashte limitit (Kap 06)		298,000.00		2,070,575.00		2,070,575.00			1,788,000.00			
Totali (Korrente + Kapitale + Shpenz. nga te ardh. jashte limiti		160,301,289.52		170,270,575.00		168,630,575.00			161,268,173.00			
Numri i puntonjëseve		0		73		73			70			



Emri: _____ Sofi Noti
 Firma: _____
 Data: 27.02.2026


Sekretari i Përgjithshëm

ANEKSI 1.1 Raporti i Shpenzimeve të Institucionit sipas kapitujve

Periudha e Raportimit 12-2025

Kodi i AIDSSH	Kodi i Kapitullit	Emërtimi i Kapitullit	Periudha raportuese Periodike /Vjetore	Buxheti	Artikujt buxhetore						Total
					231	600	601	602	606	Total	
95	01	Nga Buxheti	2025	Plani fillestar	Shpenzime Kapitalale të Trupëzuara	Pagat	Kontribe e Sigurimeve Shoqërore	Mallra dhe Shërbime	Transferta për Buxhetet Familjare dhe Individet	0	168,200,000
95	01	Nga Buxheti	2025	Plani i rishikuar	10,000,000	112,900,000	19,200,000	26,100,000	0	168,200,000	
95	01	Nga Buxheti	2025	Fakti	8,200,000	115,900,000	19,200,000	22,700,000	560,000	166,560,000	
95	01	Nga Buxheti	2025	Angazhime	7,542,188	115,274,387	18,808,948	17,398,689	455,961	159,480,173	
95	01	Nga Buxheti	2025	Angazhime	0	0	0	0	0	0	
95		Total	2025	Plani fillestar	10,000,000	112,900,000	19,200,000	26,100,000	0	168,200,000	
95		Total	2025	Plani i rishikuar	8,200,000	115,900,000	19,200,000	22,700,000	560,000	166,560,000	
95		Total	2025	Fakti	7,542,188	115,274,387	18,808,948	17,398,689	455,961	159,480,173	
95		Total	2025	Angazhime	0	0	0	0	0	0	
95		Ndryshimi ne vlerë absolute	2025		657,812	625,613	391,052	5,301,311	104,039	7,079,827	
95		Realizimi ne %	2025		92	99	98	77	81	96	
95	06	Nga të ardhurat jashtë limitit	2025	Fakti	0	1,788,000	0	0	0	1,788,000	
95	06	Nga të ardhurat jashtë limitit	2025	Angazhime	0	0	0	0	0	0	

Emri	Emri	Sofi Noti
Firma	Firma	
Data	Data	27.02.2026



Aneksi 1.2 "Shpenzimet Buxhetore në Total Programi dhe Total Institucioni "

Periudha e Raportimit 12-2025

Kodi i Ministris	Kodi i Programi	Emërtimi i Programit	Viti	Tipi i Buxhetit	Art. 231	Art. 600	Art. 601	Art. 602	Art. 606	Total
95	01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	2025	Plani fillestar	10,000,000	112,900,000	19,200,000	26,100,000	0	168,200,000
95	01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	2025	Plani i rishikuar	8,200,000	115,900,000	19,200,000	22,700,000	560,000	166,560,000
95	01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	2025	Shpenzime faktike	7,542,188	115,274,387	18,808,948	17,398,689	455,961	159,480,173
95	01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	2025	Angazhime	0	0	0	0	0	0
95		Ndryshimi ne vlere absolute	2025		657,812	625,613	391,052	5,301,311	104,039	7,079,827
95		Realizimi ne %	2025		92	99	98	77	81	96
95		Te ardhura jashte limiti	2025	Shpenzime faktike	0	1,788,000	0	0	0	1,788,000
95		Total i Ministrisë/Institucionit	2025	Plani fillestar	10,000,000	112,900,000	19,200,000	26,100,000	0	168,200,000
95		Total i Ministrisë/Institucionit	2025	Plani i rishikuar	8,200,000	115,900,000	19,200,000	22,700,000	560,000	168,300,000
95		Total i Ministrisë/Institucionit	2025	Shpenzime faktike	7,542,188	115,274,387	18,808,948	17,398,689	455,961	159,480,173
95		Total i Ministrisë/Institucionit	2025	Angazhime	0	0	0	0	0	0
95		Numri i punonjesve në Total	2025	Plani fillestar		73	73			0
95		Numri i punonjesve në Total	2025	Plani i rishikuar		73	73			0
95		Numri i punonjesve në Total	2025	Numri faktik		69	69			0



Drejtuuesi i Ekipit Menaxhues të Programit	Emri	Anton Dukagjini	Emri	Soti Noli
	Firma		Firma	
	Data	27.02.2026	Data	27.02.2026

ANEKSI nr. 2 Raporti mbi Ekzekutimin e Buxhetit në nivelin e Programit të Buxhetit

Periudha e Raportimit 12-2025

në/lekë


Emri i Grupit		Kodi i grupit										95	
Emri i		Kodi i programit										01110	
		Shpenzimet e Programit											
Kodi i Programit	Emërtimi	Viti paraardhës 2024		Periudha raportuese		Periudha raportuese		Ndryshimi i planit vjetor		Periudha raportuese		Ndryshimi Vjetor (Plan - Fakt)	% e realizimit
		Shpenzime Faktike	Struktura e shpenzimeve në %	Plani Vjetor i Rishikuar Viti 2025	Struktura e shpenzimeve në %	Plani Vjetor i Rishikuar Viti 2025	Struktura e shpenzimeve në %	Ndryshimi i planit vjetor	Shpenzime Faktike të Periudhës/Progressive	Struktura e shpenzimeve në %			
		(1)	(2)	(3)	(4)	(5)	(6)	(7 (5-3))	(8)	(9)	(10 (5-8))	(11 (8/5))	
Shpenzimet sipas klasifikimit ekonomik													
600	Paga	105,819,795.00	66	112,900,000	67	115,900,000	70	3,000,000	115,274,387.00	72	625,613	99	
601	Sigurime Shoqërore	17,119,696.00	11	19,200,000	11	19,200,000	12	0	18,808,948.00	12	391,052	98	
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	23,010,750.52	14	26,100,000	16	22,700,000	14	-3,400,000	17,398,689.00	11	5,301,311	77	
603	Subvencione	0.00	0	0	0	0	0	0	0.00	0	0	0	
604	Transferata Korente të Brendshme	0.00	0	0	0	0	0	0	0.00	0	0	0	
605	Transferata Korente të Huaja	0.00	0	0	0	0	0	0	0.00	0	0	0	
606	Trans per Buxh. Fam. & Individ	643,940.00	0	0	0	560,000	0	560,000	455,961.00	0	104,039	81	
	Nëntotali Shpenzime Korente	146,594,181.52	92	158,200,000	94	156,360,000	95	160,000	151,937,985.00	95	6,422,015	96	
230	Kapitale të Patupëzuara	0.00	0	0	0	0	0	0	0.00	0	0	0	
231	Kapitale të Trupëzuara	13,409,108.00	8	10,000,000	6	8,200,000	5	-1,800,000	7,542,188.00	5	657,812	92	
	Nëntotali Shpenzime Kapitale me financim të brendshëm	13,409,108.00	8	10,000,000	6	8,200,000	5	-1,800,000	7,542,188.00	5	657,812	92	
230	Kapitale të Patupëzuara	0.00	0	0	0	0	0	0	0.00	0	0	0	
231	Kapitale të Trupëzuara	0.00	0	0	0	0	0	0	0.00	0	0	0	
	Nëntotali Shpenzime Kapitale me financim të huaj	0.00	0	0	0	0	0	0	0.00	0	0	0	
	Totali i Shpenzimeve Kapitale	13,409,108.00	8	10,000,000	6	8,200,000	5	-1,800,000	7,542,188.00	5	657,812	92	
	Totali i Shpenzimeve Buxhetore të Programit	160,003,289.52	100	168,200,000	100	166,560,000	100	-1,640,000	159,480,173.00	100	7,079,827	96	
	Shpenzime Korente nga të Ardhurat Jashtë limitit (Kap 06)	298,000.00		2,070,579		2,070,579		0	1,788,000.00		282,579	86	
	Shpenzime Kapitale nga të Ardhurat Jashtë limitit (Kap 06)	0.00						0	0.00		0	0	
	Totali i Shpenzimeve të Programit	160,301,289.52		170,270,579		168,630,579		-1,640,000	161,268,173.00		7,362,406	96	
Shpenzimet sipas produkteve të programit buxhetor													
Artikulli	Emërtimi												
	Totali i Shpenzime Korente	146,594,181.52	92	158,200,000	94	156,360,000	95	-160,000	151,937,985.00	95	6,422,015	96	
Kodi i produktit	Emërtimi												
99501AA	Kërkesa të trajtuara	146,594,181.52	92	158,200,000	94	156,360,000	95	-160,000	151,937,985.00	95	6,422,015	96	
	Totali Shpenzime për Investime	13,409,108.00	8	10,000,000	6	8,200,000	5	1,800,000	7,542,188.00	5	657,812	92	
Kodi i produktit	Emërtimi												
18AD602	Mbyllje dhe izolim ambientesh të brendshme per zyra	1,954,856.00	1	0	0	0	0	0	0.00	0	0	0	
18AD603	Mikqirje per rmbyllje dhe izolim mbjentesh per zyra	40,458.00	0	0	0	0	0	0	0.00	0	0	0	
18AD604	Kolaudim per rmbyllje dhe izolim mbjentesh per zyra	5,000.00	0	0	0	0	0	0	0.00	0	0	0	
18BV402	Blerje pajisje kompjuterike	1,086,730.00	1	1,000,000	1	1,200,000	0.7	200,000	626,400.00	0.4	573,600	52	
18BV404	Rikonstrukion rrejet kompjuterik dhe elektrik	0.00	0	0	0	0	0.0	0	0.00	0.0	0	0	
18BV405	Blerje dhe instalim i implantit hidrik te MKZ	1,784,704.00	1	0	0	0	0.0	0	0.00	0.0	0	0	
18BV406	Blerje, instalim sisteme dhe pajisje	6,075,600.00	4	0	0	0	0.0	0	0.00	0.0	0	0	

RAPORTI 2/1 Shpenzimet e programit sipas kapitujve


Periudha e Raportimit 12-2025

Kodi i AIDSSH	Kodi i Programit	Emërtimi i Programit	Kodi i Kapitullit	mërtimi i Kapitullit	Periudha raportuese	Buxheti	Artikujt buxhetore						Total
							230	231	600	601	602	606	
					Periodike /Vjetore		Shpenzimet e Kapitale të Patrupëzuara	Shpenzime Kapitale të Trupëzuara	Pagat	Kontrib. e Sigurimeve Shoqërore	Mallra dhe Shërbime	Transferta për Buxhetet Familjare dhe Individet	Total
95	01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	01	Nga Buxheti	2025	Plani fillestar	0	10,000,000	112,900,000	19,200,000	26,100,000	0	168,200,000
95	01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	01	Nga Buxheti	2025	Plani i rishikuar	0	8,200,000	115,900,000	19,200,000	22,700,000	560,000	166,560,000
95	01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	01	Nga Buxheti	2025	Fakti	0	7,542,188	115,274,387	18,808,948	17,398,689	455,961	159,480,173
95	01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	01	Nga Buxheti	2025	Angazhime	0	0	0	0	0	0	0
95	01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi		Total	2025	Plani fillestar	0	10,000,000	112,900,000	19,200,000	26,100,000	0	168,200,000
95	01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi		Total	2025	Plani i rishikuar	0	8,200,000	115,900,000	19,200,000	22,700,000	560,000	166,560,000
